



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVA

C-II.-16-0687-C0001

Paditësi:

I.M. Podujevë

Kundër:

E paditura:

NSH, me seli në Prishtinë, të cilën e administron **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “*Agim Ramadani*”, Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Teuta Ibrahim, më 12 shtator 2019, lëshon këtë:

AKTVENDIM

Padia e Paditësit konsiderohet e tërhequr.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 13 dhjetor 2016 paditësi I.M. , Podujevë, parashitroi padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për kompensimin e pagave të papaguara gjatë masave të dhunshme të okupimit serb të NSH PUT.

Paditësi në padinë e tij thekson se është larguar nga puna më 19 tetor 1993 andaj kërkon kompensimin e pagave deri më 1 korrik 1999 respektivisht 65 paga në vlerë prej 2,275.00 euro.

Në padi kërkon nga Gjykata që padia dhe kërkesëpadia e tij të aprovohen në tërësi, që e paditura NSH të detyrohet të paguajë pagat e papaguara për periudhën e pushuar nga puna nga masat e dhunshme si dhe të obligohet e paditura për shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Paditësi si provë ka bashkëngjitur:

- Kopje e pavërtetuar e letërnjoftimit;
- Vërtetim (kopje e pavërtetuar) i lëshuar nga NSH për përvojën e punës;

Më 17 janar 2017 AKP-ja paraqet mbrojtjen e saj nr. 159 kundër padisë së paditësit. AKP-ja në mbrojtjen e saj thekson se NSH me vendim të ish AKM-së ka hyrë në procedurën e likuidimit dhe si provë bashkëngjet vendimin për fillimin e likuidimit të datës 23 maj 2007.

Përmes kësaj mbrojtjeje AKP-ja kërkon nga Dhoma e Posaçme që të pezullohet së shqyrtuari padia e paditësit I.M.kundër NSH , derisa kjo NSH është në procedurë të likuidimit.

Më 1 shkurt 2017 paditësi e ka pranuar mbrojtjen e AKP-së dhe më 10 shkurt 2017 ka dorëzuar një parashtrësë përmes së cilët kundërshtimin e AKP-së e konsideron të pabazë dhe diskriminues ndaj punëtorëve të ndërmarrjes .

Më 17 prill 2019, Zyrtarja për Financa i ka dërguar Vërejtjen për pagesën e taksave gjyqësore për paditësin duke kërkuar pagesën e taksave gjyqësore ashtu siç janë dhënë në procedurë ose të paraqesë prova që bën pjesë në kategorinë e të përjashtuarve nga kjo pagesë; Gjykata njoftoi paditësin mbi pasojat e mospagimit të kësaj pagese specifike;

Më 30 prill 2019, paditësi, është shërbyer me Vërejtjen për pagesën e taksave gjyqësore, që të paraqes prova mbi pagesën efektive të taksave gjyqësore si parashikohet nga Udhëzimi Administrativ, ose të paraqes provat që pala të cilën ai e përfaqëson është i përjashtuar nga pagesa e taksave efektive si parashikohet nga Udhëzimi Administrativ.

Arsyetimi ligjor

Padia e paditësit konsiderohet e tërhequr.

Bazuar në nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017, hyrë në fuqi më 01 maj 2017, për aplikimin e njëjtë të taksave gjyqësore, paditësit i kërkohet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga të shërbyerit dhe pranimi i urdhrin të gjykatës për të ia dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës vërtetimin dhe faturën e pagesës të shumës së caktuar që duhet paguar ose që t'i dorëzojë gjykatës prova në lidhje me faktin se ai është i liruar nga pagesa për arsye ase është përfitues i ndihmës sociale nga ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose Ndhimës Ligjore nga Zyra e Qarkut për Ndhimë Juridike.

Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017, për unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 paragrafi 5.1, parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore për procedimin në shumën e duhur, dhe në paragrafin 8 parashikon rastet kur paraqitësi i kërkesës është përjashtuar nga kjo pagesë, dhe paragrafi 8.3 parashikon dokumentet që personat e përjashtuar duhet ti paraqesin gjykatës:

- a. Një person fizik jep dëshmi se ai ose ajo është përfituesi i një ndihme sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose agjencisë që e ka pasuar; ose,

- b. Nëse personi paraqet dëshmi se ai ose ajo merr ndihmë juridike nga Zyra e Qarkut për Ndihme Juridike.

Për më tepër, Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017, Neni 5.5.2 parasheh që, "nëse pas njoftimit, pala nuk i paguan taksat gjyqësore, sipas nenit 5.1 të këtij udhëzimi, gjyqtari i caktuar për çështjen, do të aplikojë artikullin 253, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe si pasojë padia do të konsiderohet e tërhequr.

Paditësi përmes Vërejtjes për pagesën e taksave gjyqësore të datës 23 janar 2019, u informua për faktin se në bazë të nenit të lartpërmendur të Udhëzimit Administrativ, në rast të mos pagesës, ose në rast të mos paraqitjes në gjykatë, brenda afatit të caktuar prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, dëshmi se është përfitues i së drejtës për t'u liruar nga pagesa, Gjykata do të marrë një vendim duke e konsideruar çështjen në fjalë si të tërhequr.

Paditësi është shërbyer me kërkesën e zyrtarit financiar por për fat të keq pa ndonjë reagim, përgjigje apo pagesë;

Për arsyet e lartcekura gjykata nuk është lëshuar fare në merita lidhur me këtë çështje.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Teuta Ibrahim – Gjyqtare _____